



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK/DMP	Nr. Prot. 03-3274/13
Dep.	Em. Prot.
Nr. I faq.	Prot. No.
Bro. Stranica 02	Data
Nr. pages.	Data 11.10.2013
PRISHTINE	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr Regj.14837/2012

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Habib Strana nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 paragrafi 1 e ndëshkuar sipas nenit 17 par 1 .1. të Ligjit nr. 04/L-050, të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, për të gjithë personat Zyrtar, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, 9 të LMK me dt. 27.09.2013. merr këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI : Habib Strana, i lindur më 01.04.1963, në Prishtinë, ku dhe tani jeton. në rrugën “Isa Kastrati”, nr.34, Zyrtar i Lartë Publik – Shef i Sektorit të Prokurimit, në Agjencionin e Statistikave të Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse, i pandehuri në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Publik, shef i Sektorit të Prokurimit në Agjencionin e Statistikave të Kosovës, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë, i cili bëhet me deklarin e rregullt të paraparë me ligj, deri me datën 31.03.2012, të çdo viti kalendarik, në Agjencionin Kundër Korrupsionit.

Me këtë ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 8 paragrafi 1, e ndëshkuar sipas nenit 17 par 1 pika.1.1 të Ligjit nr. 04/L-050, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në shumë prej 500.-€ (pesëqind euro). Gjobën e shqiptuar, i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së. No.1000-4300-7000-0518.

Pagesa bëhet në ndonjërin Agjenci për mbledhjen e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar në këtë Divizion. Nëse brenda afatit të caktuar, i pandehuri nuk e paguan gjobën, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej 27 (njëzetëeshtatë) dite, duke llogaritur 20.-€ (njëzet euro) në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit, i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5.-€ (pesë euro), në afat të njëjtë sikurse gjobën në shërbimin e arkës së këtij Divizioni.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtrroi kërkesën nr. 01 -1619/2012 të dt.02.05.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të përmendur më lartë, për kundërvajtje të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke propozuar të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari në shkallë të parë, me dt. 22.10.2012, ka marrë aktvendim me të cilin shpallë përgjegjës dhe e dënon me dënim me gjobë në shumë prej 1000.-€ (njëmijë euro). Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Habib Strana, ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Lartë për kundërvajtje. Gjykata e Lartë me aktvendimin GJL.nr.1297/12 dt. 13.11.2012, ka aprovuar ankesën e palës si të bazuar, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e ka kthyer në plotësim të procedurës dhe rivendosje, që të merren edhe këto veprime: të dëgjohet i pandehuri dhe çfarë kundërvajtje ka kryer, si dhe dispozita ndëshkuese.

Duke vepruar sipas konstatimeve dhe vërejtjeve të theksuara më lartë, u dëgjua i pandehuri Habib Strana, i cili deklaroi se, sa i përket plotësimit të formularit për deklarin e pasurisë, përveç asaj që kam thënë më herët, dua të theksoj se formulari nga Agjencionin e Statistikave të Kosovës, gjegjësisht nga ZKM, e kam pranuar me vonesë dhe për këtë i propozoi të dëgjohet Hajriz Beqiri, i cili mund të njoftoj për këtë rrethanë. Unë po ashtu ritheksoj se mundësitë e mia financiare janë të dobëta me të ardhura 360.-€, kam dy fëmijë studenta, një kredi me kiste prej 192.-€ në muaj, si dhe jetoj me qira që më duhet të paguaj 220.-€ në muaj, duke mos i llogaritur edhe shpenzimet tjera komunale. I propozoi gjykatës që asnjë lloj dënimi nuk mund ta paguaj, pasi që i njëjti do të më rrezikoi kushtet më ekzistenciale për jetesë mua dhe familjes time, dhe çdo gjobë që më shqiptohet të ma shëndroni në dënim me burg, por se në fund dua të theksoj se nuk e kam ditë rolin dhe rëndësinë e deklarin të pasurisë, tani e kam kuptuar dhe kam vepruar me kohë në këtë vit. Kërkoj nga Gjykata që të merret si rrethanë lehtësuese.

03-3274/13/02
Aug

U dëgjua dëshmitari Hajriz Beqiri, Shef i Logjistikës dhe pika kontaktuese me Agjensionin për pranimin e formularëve dhe për dorëzimin e secilit në këtë Insitucion. Sa i përket rastit konkret, e pranoi se dorëzimi ka qenë me vonesë për palën Habib Strana, me sa e di unë, ja kam dërguar dy ditë para afatit për kalimin e deklarimit të pasurisë, për arsye se, pasi që në fillim pika kontaktuese ka qenë Shqipe Makolli, Menaxhere e Personelit dhe se në bazë të pozitës, në të gjitha Institucionet e bartë edhe këtë obligim. Përveç kësaj mosdhënia me kohë ka qenë se, ishte për herë të parë që kanë hyrë në listën e deklarimit të pasurisë, kjo kategori, pasi që nuk e kemi pasur të qartë, gjegjësisht shefat e Prokurimit, edhe pse unë mendoj se Habib Strana, në pozitën e Shefit nuk i takon kategorisë për deklarimin e pasurisë, ku ekzistojnë dallime në mes Drejtorit, Shefit dhe Udhëheqësit. U dëgjua edhe Përfaqësuesi i Agjensionit kundër Korrupsionit, Enis Sadiku, i cili deklaroi se, sa i përket kërkesës të cilën e kemi ushtruar ndaj Habib Strana, ku sipas Ligjit nr. 04/050, shihet se deklarimet janë paraparë në mënyrë taksative me ligj dhe në rastin konkret, kemi të bëjmë me deklarim të rregullt vjetor, i cili është përcaktuar me nenin 8, i cili paraqet edhe kohën të cilët janë të obliguar ta paraqesin pasurinë prej dt. 01.03.2012 deri me dt. 31.03.2012 të çdo viti kalendarik, e i ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 al.1.1 të këtij Ligji. Ne iu kemi dërguar formularët dhe njoftimet për plotësimin e këtyre formularëve, në bazë të listës të cilën e kemi marrë nga pikat e çdo Institucioni, ku në këtë listë ka qenë edhe emri i Habib Strana. Pas përfundimit të afatit ligjor për deklarimin e pasurisë, në rastin konkret për vitin 2012, kemi konstatuar se Habib Strana nuk e ka plotësuar formularin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit, as para afatit e as pa afatit, e cila është vërtetuar edhe në bazë të listave të parapara që ne i kemi, nuk figuron personi në fjalë që ka deklaruar pasurinë. Ne formularët dhe komunikimin e bëjmë përmes pikës kontaktuese të çdo Institucioni, siç është e paraparë sipas ligjit dhe si ua dorëzojmë formularët për deklarim të pasurisë, është çështje e tyre (pikës kontaktuese) dhe se, a e ka marrë apo nuk e ka marrë formularin pala, ne nuk e dimë. Gjyqtari pasi që administroi provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetoi gjendjen faktike, duke e dëgjuar të pandehurin, parashtruesin e kërkesës si dhe provat e tjera të administruara nga shkresat e lëndës, në mënyrë bindëse u vërtetua se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen, duke e shpallë përgjegjës dhe e dënon me gjobë, duke aplikuar nenin 9, me ç'rast i shqipton dënimin nën minimumin e paraparë ligjor, pasi që jeton në kushte të rënda ekonomike, është hera e parë që ka kryer kundërvajtje.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, se edhe me këtë dënim, do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmangot nga kryerja e veprave të këtylla kundërvajtëse e të ngjashme.

Andaj u vendos në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes

GJYQTARI
Fatmir Behrami

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të ushtrojnë palët Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej datës së marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmjet këtij Divizioni.